

KLSH merr pjesë në tryezën e diskutimit “Transparenca dhe menaxhimi financiar i universiteteve publike”, organizuar nga Qëndresa Qytetare dhe fondacioni “Friedrich Ebert”

Në datë 15 nëntor 2023, Qëndresa Qytetare dhe fondacioni “Friedrich Ebert” organizuan në mjediset e hotel “Rogner” në Tiranë tryezën e diskutimit me temë “*Transparenca dhe menaxhimi financiar i universiteteve publike*”.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin pedagogë nga disa universitete, gazetarë, partnerë të Qëndresës Qytetare etj. Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua në këtë takim nga drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Alfred Zylfi, z. Aulent Guri, kryeauditues dhe z. Bajram Lamaj, auditues.



Në takim u diskutua mbi opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e raportit “*Transparenca dhe menaxhimi financiar i universiteteve publike*”, i cili ka përfshirë monitorimin e 7 universiteteve publike, duke hedhur dritë mbi mënyrën se si janë shpenzuar të ardhurat e këtyre institucioneve, të cilat grumbullohen nga tarifat e studentëve dhe financimi nga buxheti i shtetit.

Z. Bajram Lamaj paraqiti disa nga gjetjet e auditimit me temë “*Performanca e universiteteve publike gjatë periudhës së pandemisë*”.



Pjesëmarrësit në takim vlerësuan problematikën e ngritur Qëndresa Qytetare lidhur me monitorimin e shpenzimeve financiare të institucioneve të arsimit të lartë publik, i cili synon të nxisë llogaridhënien publike të universiteteve ndaj studentëve dhe stimulimin e transparencës nëpërmjet pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre në vendimmarrje.